



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AKADEMIA E SHKENCAVE

Kryesia

Prot 182/12

Tiranë, ²⁷__2.2024

Vendim nr 23 datë 27.02.2024

Për zgjatjen e afatit të funksionimit të qendrës kërkimore të nanoteknologjisë (NanoAlb)

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 59/2019 Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar;

Në pajtim me nenin 44 të Statutit të ASHSH;

Me kërkesë të drejtuesit të qendrës kërkimore të nanoteknologjisë NanoAlb akad. Arben Merkoçi (bashkëngjitur) dhe me propozim të Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike (bashkëngjitur);

Pasi u njoh me relacionin me shkrim të kryetarit të kësaj qendre për aktivitetin e saj për periudhën 2022-2023 dhe me propozimet për projektet shkencore që vijojnë nga periudha dyvjeçare e funksionimit të deritashëm dhe/ose që janë përgatitur rishtas, me periudhë zbatimi vitet 2024-2025:

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës 26.2.2024,

Vendosi:

1. Të zgjatet afati i funksionimit të qendrës kërkimore të nanoteknologjisë NanoAlb, e cila deri më datë 13 janar 2024 ka vcepruar sipas vendimit nr. 5, datë 13. 01.2022 të Kryesisë, edhe për dy vjet të tjera.
2. Propozimi i paraqitur nga akad. Arben Merkoçi, drejtues i njësisë, për veprimtarinë e qendrës kërkimore NanoAlb (bashkëngjitur), i programuar edhe në programin vjetor të ASH-së, të shërbejë në dy vitet në vijim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: drejtuesit e qendrës kërkimore të nanoteknologjisë NanoAlb, sekretari shkencor, kryetari i SSHNT e kancelari.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI
KRYETAR

